



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 korrik 2020
Nr. ref.:RK 1585/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI163/18

Parashtrues

Kujtim Lleshi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit, KMLC nr. 134/2018, të Prokurorit të Shtetit, të 15 tetorit 2018, Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, AC. nr. 4737/2017, të 3 gushtit 2018 dhe Urdhrit të Përmbaruesit Privat, P. nr. 224/15, të 11 tetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Kujtim Lleshi, nga Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) i përfaqësuar nga Yll Xhiha, avokat nga Komuna e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Njoftimin [KMLC. nr. 134/2018] e 15 tetorit 2018 të Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Prokuroria e Shtetit) dhe Aktvendimin [AC. nr. 4737/2017] e 3 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Urdhrin [P.nr.224/15] e 11 tetorit 2017 të Përmbauesit Privat Gj.R. (në tekstin e mëtejme: Përmbauesi Privat).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit, Aktvendimit dhe Urdhrit të lartcekur përmes të cilëve, sipas pretendimit, parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me paragrafin 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, duke mos saktësuar se cilat nene të këtyre dy instrumenteve ndërkombëtare, janë cenuar në rastin e tij.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

5. Më 23 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 31 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një Aktvendim të Gjykatës Supreme në lidhje me një rast tjetër të zhvilluar në procedurë përmbaimore dhe i cili, sipas parashtruesit të kërkesës, është nxjerrë në rrethana të njëjta sikurse ato të rastit të tij.
7. Më 5 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 14 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi formularin e plotësuar në Gjykatë.
9. Më 26 nëntor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë formularin zyrtar të Gjykatës dhe të

dorëzohet autorizimin që dëshmon se avokati, Yll Xhiha, e përfaqëson atë në Gjykatë.

10. Më 6 dhjetor 2018, Gjykata pranoi formularin e plotësuar të kërkesës nga parashtruesi i kërkesës dhe autorizimin për përfaqësim të tij në Gjykatë.
11. Më 27 qershor 2019, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta informojë Gjykatën se në cilën fazë gjendet rasti dhe i kërkoi të sqarojë nëse ka pasur ndonjë zhvillim procedural, duke bashkëngjitur dokumentacionin përkatës. Në vijim, Gjykata po ashtu i kërkoi parashtruesit të kërkesës të specifikojë saktë se cilin vendim apo vendime të autoriteteve publike i konteston para Gjykatës.
12. Më 12 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e informoi Gjykatën lidhur me statusin e rastit dhe specifikoi se e konteston edhe Urdhrin [P. nr. 224/15] të 11 tetorit 2017 të Përmbaruesit Privat.
13. Më 23 prill 2020, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës: Prokurorisë së Shtetit, Gjykatës së Apelit, Përmbaruesit Privat dhe Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. (në tekstin e mëtejme: Raiffeisen Banka).
14. Më 24 qershor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 23 dhjetor 2005, "Be-Kom" sh.p.k, i përfaqësuar nga parashtruesi i kërkesës dhe Raiffeisen Bank, nënshkruan një Marrëveshje mbi Kredinë [nr.13575] në vlerë prej katërqind mijë (400,000) euro. Marrëveshja e lartcekur, u nënshkrua nga parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e kredimarrësit; F.Ll., përkatësisht, bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës, në cilësinë e kredimarrëses; B.Ll. dhe E. Ll., në cilësinë e bashkëkredimarrësve, si S.Ll. e B.C., respektivisht, në cilësinë e bashkëshortëve të bashkëkredimarrësve. Marrëveshja mbi Pengun, ishte shtojcë e Marrëveshjes së lartcekur mbi Kredinë. E njëjta ishte nënshkruar nga personat e lartcekur.
16. Ndërmjet 18 shtatorit 2007 dhe 11 shtatorit 2011, parashtruesi i kërkesës, si përfaqësues i "Be-Kom" sh.p.k, B.Ll. dhe E.Ll. dhe Raiffeisen Bank, po ashtu kishin nënshkruar edhe marrëveshje të tjera mbi kredinë: Marrëveshje mbi Linjën e Kredisë, Marrëveshje mbi Pengun dhe Marrëveshje mbi Hipotekën. Marrëveshjet mbi Hipotekën ishin regjistruar në Zyrën Kadastrale në Gjakovë sipas Aktvendimeve, si në vijim: (i) Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës [nr. i protokollit 337/07] të 19 shtatorit 2007 nga Zyra Kadastrale në Gjakovë në emër B.Ll.-së; si dhe (ii) Aktvendimet, [nr. i protokollit 337/07] të 19 shtatorit 2007; [nr. 142/08] të 22 prillit 2008; [nr. 345/08] të 19 shtatorit 2008; dhe [nr. 254/08] të 14 korrikut 2008, në emër të parashtruesit të kërkesës.
17. Në një datë të paspecifikuar, sipas shkresave të lëndës dhe marrë parasysh që Marrëveshja mbi Kredinë nuk ishte respektuar nga kredimarrësit, rrjedhimisht edhe nga bashkëkredimarrësit përkatës, Raiffeisen Bank, në cilësinë e kreditorit iu drejtua Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) me propozimin për fillimin e procedurës përmbarimore.

18. Më 4 prill 2012, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [E.nr.305/2012] lejoi propozimin e Raiffeisen Bankës për përmbarim për shumën e borxhit në vlerë prej 803,360.62 euro, lidhur me titujt përmbarues, siç ishin listuar në propozimin e saj për përmbarim.
19. Më 18 prill 2012, kundër Aktvendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës dhe bashkëkredimarrësit, në cilësinë e debitorëve (në tekstin e mëtejme: debitorët), parashtruan prapësim në të njëjtën Gjykatë. Kundër këtij prapësimi, më 23 prill 2012, Raiffeisen Bank, në cilësinë e kreditorit, kishte parashtruar përgjigje.
20. Më 15 janar 2013, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit me të njëjtin numër si ai i 4 prillit 2012, përkatësisht [E.nr.305/12], refuzoi prapësimin e debitorëve si të pabazuar, duke theksuar se ankesa kundër të njëjtin Aktvendim, nuk e ndalon ekzekutimin.
21. Më 25 janar 2013, kundër Aktvendimit të lartcekur, debitorët parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit. Përgjigje në ankesë, më 31 janar 2013, kishte parashtruar edhe Raiffeisen Banka.
22. Më 5 nëntor 2013, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.1599/13] ankesën e debitorëve e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin [E.nr. 305/12] të 15 janarit 2013 të Gjykatës Themelore.
23. Më 12 mars 2015, Gjykata Themelore përmes Konkluzionit [E.nr.305/12] lëndën përmbarimore e transferoi te Përmbaruesi Privat.
24. Më 10 prill 2015, Përmbaruesi Privat nxori Konkluzionin [P.nr. 224/15] përmes të cilit caktoi shitjen e paluajtshmërisë, të lënë në hipotekë, duke e përcaktuar seancën e parë për shitje, më 11 maj 2015.

Procedura përkitazi me eliminimin e parregullsive në procedurën përmbarimore

25. Më 5 maj 2015, bazuar në nenin 52 (Parregullsitë me rastin e kryerjes së përmbarimit) të Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejme: LPP), debitorët parashtruan kërkesë për eliminimin e parregullsive të Përmbaruesit Privat në Gjykatën Themelore.
26. Më 7 tetor 2015, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP. nr. 74/15] revokoi konkluzionin e Përmbaruesit Privat [P.nr. 224/15] të 10 prillit 2015, duke urdhëruar këtë të fundit që të caktojë ekspertin për përcaktimin e vlerës së paluajtshmërive, në mënyrë që pas vlerësimit të ekspertit, të vazhdohet me procedurën e shitjes së paluajtshmërive përkatëse.
27. Më 22 tetor 2015, Përmbaruesi Privat në pajtim me Aktvendimin e lartcekur, përmes Konkluzionit [P.nr.224/15], caktoi ekspertin për vlerësimin e paluajtshmërive. Bazuar në shkresat e lëndës, pas vlerësimit të ekspertit, Përmbaruesi Privat, përmes Konkluzioneve të 24 nëntorit 2016 dhe të 23 gushtit 2017, respektivisht, caktoi shitjen e parë dhe të dytë të paluajtshmërive përmes ankandeve publike.

28. Në një datë të paspecifikuar, kundër Konkluzioneve të lartcekura të Përmbauesit Privat për shitjen e paluajtshmërive përmes ankandit publik, debitorët parashtruan edhe një kërkesë për eliminimin e parregullsive në procedurën përmbaimore.
29. Më 12 janar 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP. nr. 85/2016], refuzoi kërkesën e debitorëve për eliminimin e parregullsive në procedurën përmbaimore si të pathemeltë.
30. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktvendimit të lartcekur, debitorët parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktvendimi i kontestuar të prishet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.
31. Më 17 tetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 845/2017] e refuzoi si të pabazuar ankesën e debitorëve, dhe vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr.85/2016] e 12 janarit 2017 të Gjykatës Themelore.

Procedura përmbaimore përkitazi me Urdhrat [P. nr. 224/15] e 6 janarit 2017 dhe [P.nr.224/15] e 11 tetorit 2017 të Përmbauesit Privat për shitjen e paluajtshmërive

32. Më 6 janar 2017, pas seancës së tretë publike, Përmbauesi Privat nxori Urdhrin [P.nr.224/15], përmes të cilit, (i) ia shiti Raiffeisen Bankës, paluajtshmëritë e debitorëve të përcaktuara përmes këtij Urdhri, në vlerën e përgjithshme prej 289,059.03 euro; (ii) i detyroi debitorët që paluajtshmëritë përkatëse t'ia dorëzojnë në posedim kreditorit; dhe (iii) urdhëroi Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Gjakovë që paluajtshmëritë përkatëse, ti regjistrojë në regjistrin e të drejtave të pronave të paluajtshme në emër të blerësit, respektivisht Raiffeisen Bankës. Bazuar në shkresat e lëndës, shuma e lartcekur i përgjigjet një të tretës (1/3) së vlerës së përcaktuar në Konkluzionet e Përmbauesit Privat të 24 nëntorit 2016.
33. Më 17 janar 2017, kundër Urdhrit të lartcekur të Përmbauesit Privat, debitorët parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Përgjigje në ankesë, kishte parashtruar edhe Raiffeisen Banka.
34. Më 11 tetor 2017, pas seancës së tretë publike, Përmbauesi Privat nxori Urdhrin [P.nr.224/15], përmes të cilit, (i) ia shiti Raiffeisen Bankës, paluajtshmëritë e debitorëve të përcaktuara përmes këtij Urdhri, në vlerën e përgjithshme prej 533,344.00 euro; (ii) i detyroi debitorët që paluajtshmëritë përkatëse t'ia dorëzojnë në posedim kreditorit; dhe (iii) urdhëroi Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Gjakovë që paluajtshmëritë përkatëse, t'i regjistrojë në regjistrin e të drejtave të pronave të paluajtshme në emër të blerësit, respektivisht Raiffeisen Bankës. Bazuar në shkresat e lëndës, shuma e lartcekur i përgjigjet një të tretës (1/3) së vlerës së përcaktuar në Konkluzionin e Përmbauesit Privat të 23 gushtit 2017.

35. Më 18 tetor 2017, kundër Urdhrit të lartcekur të Përmbauesit Privat, debitorët parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale. Përgjigje në ankesë, kishte parashtruar edhe Raiffeisen Banka. Përmes kësaj ankese, debitorët, ndër të tjera, kontestuan (i) kompetencën profesionale të ekspertit B.K.; (ii) faktin se i njëjti *“nuk është në listën e ekspertëve gjyqësor të Gjykatës në territorin e së cilës edhe Përmbauesi Privat”*; dhe (iii) përmbajtjen e vlerësimit përkatës.
36. Më 3 gusht 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [Ac. nr. 4737/2017] përmes të cilit ankesat e debitorëve i refuzoi si të pabazuara dhe vërtetoi Urdhrat [P. nr. 224/15] të 6 janarit 2017 dhe [P. nr. 224/15] të 11 tetorit 2017 të Përmbauesit Privat për shitjen e paluajtshmërive të debitorëve.
37. Më 27 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës i kishte dorëzuar Prokurorit të Shtetit një propozim për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit [Ac.nr.4737/2017] të 3 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe Urdhrit [P. nr. 224/15] të 11 tetorit 2017 të Përmbauesit Privat.
38. Më 15 tetor 2018, Prokurori i Shtetit përmes Njoftimit [KMLC.nr.134/2018], e njoftoi parashtruesin e kërkesës se propozimi për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është refuzuar, me arsyetimin se *“në këtë çështje nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 247.1 pika a) dhe pika b) e Ligjit të Procedurës Kontestimore”*.
39. Më 30 nëntor 2018, Zyra Kadastrale në Komunën e Gjakovës përmes Konkluzionit [Nr. i lëndës/protokollit: 11-940/01-31055/18 - DGJKP: 2283/18] aprovoi kërkesën e Raiffeisen Bankës për bartjen e pronës sipas Urdhrit [P.nr. 224/15] të 6 janarit 2017 për njësitë kadastrale (shtatë njësi kadastrale), të cilat i kishte listuar në këtë Konkluzion.
40. Më 23 janar 2019, Përmbauesi Privat përmes Konkluzionit [P.nr. 224/15] obligoi parashtruesin e kërkesës, si dhe B.Ll. dhe E. Ll., në cilësinë e debitorëve, që t'i lirojnë paluajtshmëritë e të cilat janë objekt i procedurës së përmbaimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Njoftimi [KMLC. nr. 134/2018] i 15 tetorit 2018 i Prokurorit të Shtetit, Aktvendimi [Ac. nr. 4737/2017] i 3 gushtit 2018 i Gjykatës së Apelit dhe Urdhri [P. nr. 224/15] i 11 tetorit 2017 i Përmbauesit Privat, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me paragrafin 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Siç është sqaruar më lart, parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas dhe të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, duke mos saktësuar se cilat nene të këtyre dy instrumenteve ndërkombëtare janë cenuar në rastin e tij.

42. Përkitazi me pretendimet e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se (i) Kontrata mbi Kredinë, pjesë e së cilës ishte edhe Kontrata mbi Pengun *“nuk ishte e legalizuar apo e noterizuar”*, dhe rrjedhimisht, një dokument i tillë, nuk mund të konsiderohet dokument përmbarues në kuptim të nenit 21 (Bazat juridike për caktimin e përmbarimit) të LPP-së, sepse i njëjti, nuk është dokument noterial i përmbarueshëm, dhe as kontratë për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit, siç është përcaktuar në nenin 22 (Dokumenti përmbarues) të LPP-së. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Kontrata për Kredinë është nule, duke iu referuar nenit 89 (Nuliteti) të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejshëm: LMD), dhe se rrjedhimisht, bazuar në nenin 66 (Përfundimi i procedurës përmbarimore) të LPP-së, procedura përmbarimore duhet të përfundojë sipas detyrës zyrtare. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i referohet një Aktvendimi të Gjykatës Supreme, që pretendon të ngërthejë rrethana të njëjta me ato të rastit të tij; (ii) bashkëshortja e tij F. Ll., nuk kishte dhënë *“pëlqimin për hipotekimin”* dhe rrjedhimisht, shitja e hipotekës është në kundërshtim me nenin 139 (Autorizimi për shitjen e sendit të lënë peng) të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera sendore (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera sendore). Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës po ashtu njofton Gjykatën se në kuadër të një kërkeje për masë të sigurisë, procedura kontestimore është në zhvillim e sipër dhe e cila gjithashtu ka në shqyrtim *“mungesën e pëlqimit për hipotekimin”*, procedurë kjo përkitazi me të cilën parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar në Gjykatë asnjë dokument; dhe në fund (iii) se Përmbaruesi Privat gjatë procedurës përmbarimore *“në kundërshtim me dispozitat ligjore”* caktoi ekspert për vlerësimin e paluajtshmërive, i cili nuk ishte i licencuar në territorin ku zhvillohej procedura përmbarimore dhe nuk figuronte në listën e ekspertëve për lëminë përkatëse.
43. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se Raiffeisen Banka (i) *“nuk veproi në përputhje me Ligjin kur disbursoi një linjë kreditore respektivisht injoroi procedurat bankare dhe atë ligjore për legalizimin e kontratës së kredisë [...] dhe regjistrimin e pengut që janë parakusht për një përmbarim të mirëfilltë poashtu dhe lëshim kredie.”*; (ii) nuk kishte precizuar *“borxhin, interesin e rregullt dhe penaltitetet”* në Kontratën mbi Kredinë; dhe (iii) *“procesi i disbursimit nga ana e Raiffeisen Bankës është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin”*.
44. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se vendimet e kontestuara janë nxjerrë në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 3, dhe neneve 33, 46 dhe 54 të Kushtetutës, dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut.
45. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të *“Obligoj Organin Përmbarues të hedh poshtë Propozimin për përmbarim si të kundërligjshëm për shkak të kontratave të kredisë dhe pengut të palegalizuar, dhe parregullsive të ndodhura gjatë procesit, ose kthehet procedura përmbarimore në pikën zero, për shkak se kreditori kishte përmbysur procedurat bankare dhe ligjore në momentin e lëshimit të kredisë”*.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Ligji nr. 03/L-008 për Procedurën Përmbarimore, i shfuqizuar me Ligjin nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, të publikuar në Gazetën Zyrtare më 3 janar 2013

Neni 23

Bazat juridike për caktimin e përmbarimit

Gjykata e cakton përmbarimin vetëm në bazë të titullit ekzekutiv (titulus executionis) apo të dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.

Neni 24

Titulli ekzekutiv

24.1 Tituj ekzekutiv janë:

- a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive ;
- b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër ;
- c) dokumenti noterial ekzekutiv;
- d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.

Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore

Neni 21

Bazat juridike për caktimin e përmbarimit

Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.

Neni 22

Dokumenti përmbarues

1. Dokumente përmbaruese janë:

- 1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;*
- 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia);*
- 1.3. dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë;*
- 1.4. marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës;*
- 1.5. aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës;*
- 1.6. vendimet dhe marrëveshjet përmbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata;*
- 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit;*
- 1.8. vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarues evropian; 1.9. dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues.*

Neni 66

Përfundimi i procedurës përmbarimore

1. Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbarimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përmbarimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar, apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt, apo në qoftë se vërtetimi për përmbarueshmërinë e tij anulohet me vendim të formës së prerë. Përmbarimi do të mbarojë gjithashtu sipas detyrës zyrtare nëse një rast 24 është pezulluar dy (2) herë dhe për herë të plotëson kriteret për pezullim siç përcaktohet në paragrafin 1. neni 65. të këtij ligji.

[...]

Neni 217

Mënyra e caktimit të vlerës

1. Për mënyrën e caktimit të vlerës së paluajtshmërisë organi përmbarues vendosë me konkluzion, menjëherë pasi ta nxjerrë aktvendimin për

përmbarrimin ose urdhrin për përmbarrim. Nëse e do nevoja, para se të nxjerrë konkluzionin, organi përmbarrues do të mbajë seancë dëgjimore me palët.

2. Përcaktimi i vlerës së paluajtshmërisë bëhet pasi të bëhet i përmbarrueshëm aktvendimi për përmbarrimin ose urdhri për përmbarrim.

3. Përcaktimi i vlerës do të bëhet edhe para momentit të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, në qoftë se këtë e kërkon kreditori dhe i paguhen shpenzimet e përcaktimit të vlerës së paluajtshmërisë edhe për rastin nëse procedura përmbarrimore pezullohet.

4. Vlera e paluajtshmërisë përcaktohet në bazë të çmuarjes së ekspertit dhe të fakteve të tjera në lartësinë e çmimit të tij të tregut në ditën e çmuarjes.

5. Me rastin e përcaktimit të vlerës së paluajtshmërisë merret parasysh edhe fakti se sa vlen ajo më pak, për shkak se në te mbeten të drejtat e caktuara edhe pas shitjes.

Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve

Neni 89

Nuliteti

1. Kontrata që është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese, ose moralin e shoqërisë është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës së cenuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diç tjetër.

2. Në qoftë se lidhja e kontratës së caktuar është e ndaluar vetëm për njërën palë, kontrata do të jetë e vlefshme, në qoftë se në ligj nuk është parashikuar ndryshe për rastin e caktuar, ndërsa pala që e ka cenuar ndalesën ligjore do të pësojë pasoja përkatëse.

Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera sendore

Neni 139

Autorizimi për shitjen e sendit të lënë peng

1. Pengdhënësi duhet të jetë pronar i sendit të lënë peng në kohën e lënies së pengut. Nëse pengdhënësi nuk është pronar i sendit të lënë peng, ai duhet të ketë autorizimin ligjor për vënien e të drejtës së pengut.

2. Pasuria e një bashkëpronësie ose të një pronësie të përbashkët mund të lihet peng vetëm nëse të gjithë bashkëpronarët ose pronarët e përbashkët e japin pëlqimin për pengun.

3. Ndonjë person i cili është pronar i një interesi të pjesshëm në pasurinë e luajtshme mund ta lë peng atë interes pa pëlqimin e pronarëve tjerë të interesit të pjesshëm.

Pranueshmëria e kërkesës

46. Gjykata së pari, shqyrton nëse parashtruesi e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

48. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

49. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Njoftimin [KMLC. nr. 134/2018] të 15 tetorit 2018 të Prokurorit të Shtetit dhe Aktvendimin [Ac. nr. 4737/2017] e 3 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Urdhrin [P. nr. 224/15] e 11 tetorit 2017 të Përmbarruesit Privat, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

50. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Në këtë aspekt, Gjykata do t'u referohet rregullave relevante të Rregullores së punës, si në vijim:

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,

(...)

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

51. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me një Marrëveshje kredie e hipoteke, mosrespektimi i kushteve të të cilës, rezultoi në fillimin e procedurave përmbartimore nga Raiffeisen Banka. Në prill të vitit 2012, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [E.nr.305/2012] lejoi propozimin e Raiffeisen Bankës për shumën e borxhit në vlerë prej 803,360.62 euro, lidhur me titujt përmbartues, siç ishin listuar në propozimin e saj për përmbartim, përkitazi me të cilin u refuzua edhe prapësimi edhe ankesa, nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, respektivisht, dhe çështja u transferua te Përmbartuesi Privat. Ky i fundit, nxori Konkluzionin për shitjen e paluajtshmërive përkatëse, Konkluzion ky i cili u revokua nga Gjykata Themelore në tetor të vitit 2015, pas kërkesës së debitorëve për eliminimin e parregullsive në procedurë përmbartimore, duke urdhëruar caktimin e një eksperti për përcaktimin e vlerës së paluajtshmërive të hipotekuara. I njëjti u caktua nga Përmbartuesi Privat, dhe pas përfundimit të vlerësimit nga eksperti, vazhdoi procedura e nxjerrjes së Konkluzioneve të radhës për shitjen e paluajtshmërive, si rezultat i të cilave, debitorët sërish parashtruan kërkesë për eliminimin e parregullsive në procedurë përmbartimore, kërkesë kjo që u refuzua edhe nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit. Shitjet publike të paluajtshmërive të debitorëve, u realizuan në seancën e tretë publike, në datat 6 janar dhe 11 tetor të vitit 2017, përmes Urdhrave [P. nr. 224/15] të 6 janarit 2017 dhe [P. nr. 224/15] të 11 tetorit 2017, respektivisht, në dobi të Raiffeisen Bankës. Ankesa në Gjykatë të Apelit kundër këtyre Urdhrave dhe propozimi për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit, u refuzuan.
52. Parashtruesi i kërkesës i konteston këto konstatime para Gjykatës, duke pretenduar (i) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës; dhe (ii) shkelje të paragrafit 2 të nenit 3, neneve 33, 46 dhe 54 të Kushtetutës dhe Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas e të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Gjykata thekson se përkundër faktit që parashtruesi i kërkesës para Gjykatës, konteston edhe Njoftimin [KMLC. nr. 134/18] e 15 tetorit 2018 të

Prokurorit të Shtetit, i njëjti nuk ka paraqitur para Gjykatës asnjë argument në këtë aspekt, dhe rrjedhimisht, Gjykata, në vlerësimin e saj, do të fokusohet në Aktvendimin [AC. nr. 4737/2017] e 3 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Urdhrin [P.nr.224/15] e 11 tetorit 2017 të Përmbauesit Privat. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës nuk ka kontestuar para Gjykatës edhe Urdhrin tjetër të Përmbauesit Privat, përkatësisht [P.nr. 224/15] të 6 janarit 2017.

53. Përkitazi me kategorinë e parë të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht atyre që ndërlidhen me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se (i) Kontrata mbi Pengun “*nuk ishte e legalizuar apo e noterizuar*”, dhe se për pasojë, një dokument i tillë, nuk mund të konsiderohet dokument përmbaues në kuptim të nenit 21 të LPP-së sepse i njëjti, nuk është dokument noterial i përmbaueshëm, dhe as kontratë për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit, siç është përcaktuar në nenin 22 të LPP-së; dhe se për pasojë, bazuar në nenin 89 të LMD-së, Kontrata për Kredinë është nule, dhe se rrjedhimisht, bazuar në nenin 66 të LPP-së, procedura përmbaimore duhet të përfundojë sipas detyrës zyrtare. Siç është sqaruar më lart, në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i referohet një Aktvendimi të Gjykatës Supreme, që pretendon të ngërthejë rrethana të njëjta me ato të rastit të tij; (ii) bashkëshortja e tij F. Ll. nuk kishte dhënë “*pëlqimin për hipotekimin*” dhe rrjedhimisht, shitja e hipotekës është në kundërshtim me nenin 139 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera sendore; dhe (iii) se Përmbauesi Privat gjatë procedurës përmbaimore “*në kundërshtim me dispozitat ligjore*” caktoi ekspert për vlerësimin e paluajtshmërive, i cili nuk ishte i licencuar në territorin ku zhvillohej procedura përmbaimore dhe nuk figuronte në listën e ekspertëve për lëminë përkatëse.
54. Gjykata, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, fillimisht do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht do të vlerësojë (i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me nulitetin e Kontratës së Kredisë dhe Hipotekës si rezultat i mungesës së “*legalizimit apo noterizimit të tyre*” dhe mungesës së “*pëlqimit për hipotekimin*” nga bashkëshortja e tij përkitazi me Kontratën për Hipotekën, me qëllim të konstatimit nëse janë shëruar mjetet juridike në aspektin formal dhe substancial siç është përcaktuar në rregullin 39 (1) (b) të lartcekur të Rregullores së punës; ndërsa më pas, do të vlerësojë (ii) pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me faktin se Përmbauesi Privat gjatë procedurës përmbaimore “*në kundërshtim me dispozitat ligjore*” caktoi ekspert për vlerësimin e paluajtshmërive, i cili nuk ishte i licencuar në territorin ku zhvillohej procedura përmbaimore dhe nuk figuronte në listën e ekspertëve për lëminë përkatëse. Në fund, Gjykata do të vazhdojë me vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet e neneve 3, 33, 46 e 54 të Kushtetutës dhe të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas dhe të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, respektivisht. Në vlerësimin e pranueshmërisë së këtyre pretendimeve, Gjykata gjithashtu do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të

Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

55. Siç është sqaruar më lart, Gjykata fillimisht do të vlerësojë (i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me nulitetin e Kontratës së Kredisë dhe Hipotekës si rezultat i mungesës së *“legalizimit apo noterizimit të tyre”* dhe mungesës së *“pëlqimit për hipotekimin”* nga bashkëshortja e tij përkitazi me Kontratën për Hipotekën; për të vazhduar me vlerësimin e (ii) pretendimeve lidhur me përcaktimin e ekspertit për vlerësimin e vlerës së paluajtshmërive përkatëse *“në kundërshtim me dispozitat ligjore”*.
- (i) *Lidhur me “nulitetin” e Kontratës për Kredinë dhe mungesës së “pëlqimit për hipotekimin”*
56. Gjykata fillimisht vëren që nga shkresat e lëndës, nuk rezulton që parashtruesi i kërkesës të ketë ngritur pretendimin përkitazi me nulitetin e Marrëveshjes së Kredisë si rezultat i mungesës së pretenduar të *“legalizimit apo noterizimit të saj”*, në procedurat para gjykatave të rregullta. Për më tepër, e njëjta vlen edhe përkitazi me mungesën e pretenduar të nënshkrimit të bashkëshortes së tij në Marrëveshjen për Hipotekën. Në këtë aspekt, vet parashtruesi i kërkesës thekson se lidhur me këtë çështje, në bazë të një kërkesë për masë të sigurisë është duke u zhvilluar një procedurë e ndarë kontestimore, përkitazi me të cilën, i njëjti nuk i ka dorëzuar shkresat përkatëse në Gjykatë.
57. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar se gjatë cilës fazë të procedurës përmbarimore është parashtruar një kërkesë e tillë për masë të sigurisë në procedurë kontestimore, dhe po ashtu nuk ka saktësuar se para cilës gjykatë procedura kontestimore është në zhvillim e sipër. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar nëse këtë kërkesë për masë të sigurisë, për të cilën nuk ka dorëzuar asnjë dokument apo vendim të gjykatës e ka (i) parashtruar pas nxjerrjes së Aktvendimit të kontestuar [Ac. nr. 4737/2017] të 3 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit apo Njoftimit [KMLC. nr. 134/2018] të 15 tetorit 2018 të Prokurorisë së Shtetit, apo (ii) një kërkesë të tillë e ka inicuar në të njëjtën kohë kur procedura përmbarimore para gjykatave të rregullta ka qenë duke u zhvilluar. Megjithatë, në shkresat e lëndës para Gjykatës, nuk rezulton që pretendimi i parashtruesit të kërkesës që bashkëshortja e tij nuk e ka nënshkruar Marrëveshjen për Hipotekën, të jetë ngritur ndonjëherë në procedurat përmbarimore të cilat kontesohen para Gjykatës në këtë rast.
58. Në një kontekst të tillë, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial.
59. Gjykata fillimisht thekson se, përderisa në kontekstin e makinerisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rregulli për shterimin e mjeteve juridike duhet të aplikohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa ndonjë formalizëm të tepruar, ky rregull zakonisht kërkon që ankesat e pretendimet që synohen të ngrihen më vonë në proces gjyqësor, duhet të jenë ngritur edhe para gjykatave të rregullta,

të paktën në substancë dhe në respektim të kushteve formale dhe afateve të përcaktuara përmes ligjit të aplikueshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 korrikut 2015, paragrafi 89 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës, KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2009, paragrafi 71; KI 154 /17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 92; dhe KI155/18, parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019, paragrafi 50).

60. Edhe më specifiku, GJEDNJ mban qëndrimin se, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 93; dhe rastin KI155/18, cituar më lart, paragrafi 49).
61. Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "substancë" para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dyja kuptimet (shih, po ashtu, rastet e Gjykatës, KI71/18, parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafin 73; dhe rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 94).
62. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se këto pretendime specifike të parashtruesit të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë gjykatave të rregullta, përfshirë Gjykatën e Apelit, të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin

KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74; dhe rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 95).

63. Gjykata gjithashtu vëren që parashtruesi i kërkesës i referohet një Aktvendimi të Gjykatës Supreme, i cili pretendon të jetë nxjerrë në rrethanat të njëjta me rastin e tij. Gjykata në këtë aspekt thekson fillimisht që një pretendim i tillë nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata, duke marrë parasysh konstatimin se pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk e plotësojnë kriterin e shterimit të mjeteve juridike në aspektin substancial. Megjithatë, Gjykata për arsye sqarimi thekson se ajo i ka vendosur parimet e përgjithshme përkitazi me mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencës në praktikën gjyqësore në kontekst të garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta në një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përmes Aktgjykimeve KI35/18, me parashtrues, *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 6 janarit 2020 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi KI35/18) dhe KI87/18, me parashtrues, *IF Skadeforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019.
64. Përmes këtyre rasteve, Gjykata fillimisht ka sqaruar se është detyrë e çdo parashtruesi të kërkesës të argumentojë divergjencën në praktikën përkatëse gjyqësore, pasi që nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Në rastin e Gjykatës KI35/18, Gjykata kishte theksuar se në raste të tilla, përkatësisht pretendimit për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, parashtruesit e kërkesave duhet t'i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur në mënyra të ndryshme nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në divergjencë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë aspekt, rastin e Gjykatës KI35/18, cituar më lart, paragrafi 76).
65. Parashtruesi i kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, nuk e ka përmbushur këtë detyrim. Për më tepër, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata në Aktgjykimin KI35/18 ka sqaruar, se përmes krahasimit të vetëm dy (2) vendimeve edhe nëse të njëjtat mund të jenë kundërthënëse, nuk mund të konstatohen "*dallime të thella dhe afatgjata*", si njëri nga tri kriteret e nevojshme për të konstatuar divergjencën në praktikë gjyqësore. Në një rrethanë të tillë, ku parashtruesit përkatës i referohen vetëm një vendimi, i cili, sipas pretendimit, përmban konstatim dhe përfundim ndryshe nga vendimi i nxjerrë në rastin e tij/saj, Gjykata nuk mund të konstatojë se është cenuar parimi i sigurisë juridike (shih rastin e Gjykatës KI35/18, të cituar më lart, paragrafët 104 dhe 114; dhe rastin KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 75).
66. Si rrjedhojë, për sa i përket pretendimeve të lartcekura të parashtruesit të kërkesës përkitazi me nulitetin e Kontratës së Kredisë dhe Hipotekës si rezultat i mungesës së "*legalizimit apo noterizimit të tyre*" dhe mungesës së "*pëlqimit për hipotekimin*" nga bashkëshortja e tij përkitazi me Kontratën për Hipotekën, Gjykata konstaton se ato duhet të refuzohen si të papranueshme në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike,

siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) *Lidhur me përcaktimin e ekspertit për vlerësimin e vlerës së paluajtshmërisë “në kundërshtim me dispozitat ligjore”*

67. Në vijim, Gjykata gjithashtu do të vlerësojë pretendimin e parashtguesit të kërkesës përkitazi me faktin se Përmbartuesi Privat gjatë procedurës përmbartimore “në kundërshtim me dispozitat ligjore” caktoi ekspert për vlerësimin e paluajtshmërive, i cili nuk ishte i licencuar në territorin ku zhvillohej procedura përmbartimore dhe nuk figuronte në listën e ekspertëve për lëminë përkatëse.

68. Në adresimin e këtij pretendimi, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtguesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, përkatësisht kriterin që kërkesa ose një pretendim që ngërthen e njëjta, të mos jetë qartazi e pabazuar, në mënyrë që të shpallet e pranueshme. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

69. Ky rregull, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë të papranueshme si “qartazi e pabazuar” një kërkesë në tërësinë e saj ose vetëm ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, pretendimet “qartazi të pabazuara” mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, më saktësisht, për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284).

70. Gjykata konsideron se pretendimi i parashtguesit të kërkesës përkitazi me faktin se Përmbartuesi Privat gjatë procedurës përmbartimore “në kundërshtim me dispozitat ligjore” caktoi ekspert për vlerësimin e paluajtshmërive, i cili nuk ishte i licencuar në territorin ku zhvillohej procedura përmbartimore dhe nuk figuronte në listën e ekspertëve për lëminë përkatëse, bie në kategorinë e pretendimeve “të shkallës së katërt”, sepse ngërthen çështje që ndërlidhen me interpretimin dhe aplikimin e ligjit, përkatësisht “ligjshmërisë” dhe jo “kushtetutshmërisë”.

71. Më saktësisht, dhe për sa i përket pretendimeve “të shkallës së katërt”, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së (shih në këtë

kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2."Shkalla e katërt", paragrafët 262 dhe 263), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretim dhe aplikim të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 60).

72. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
73. Në këtë drejtim, dhe në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata nuk mund, si rregull i përgjithshëm, të vë në dyshim gjetjet dhe konkluzionet e gjykatave të rregullta që kanë të bëjnë me: (i) vërtetimin e fakteve të rastit; (ii) interpretimin dhe zbatimin e ligjit; (iii) pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave në gjykim; (iv) drejtësinë substanciale të rezultatit të një kontesti civil; apo edhe (v) fajin ose pafajësinë e të akuzuarit në procedurën penale (shih, gjithashtu, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2."Shkalla e katërt", paragrafi 264).
74. Gjykata gjithashtu thekson faktin se në vlerësimin e pretendimeve "*të shkallës së katërt*" e që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ajo gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se "*drejtësia*" e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është një drejtësi "*substanciale*", por drejtësi "*procedurale*". Ky koncept në aspektin praktik, në parim, nënkupton (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të këtyre procedurave, të sjellin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat në mënyrë të duhur; dhe se, për pasojë, procedura, marrë si tërësi, do të rezultonte si e drejtë (shih, gjithashtu, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2."Shkalla e katërt",

paragrafi 264 dhe referencat e përmendura aty). Për më tepër, drejtësia e një procedure vlerësohet në tërësinë e saj, dhe kjo është një ndër premiset kryesore të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës, KI104/16, parashtues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe KI143/16, parashtues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

75. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta, kanë detyrë primare të zgjedhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlihet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtuesin përkatës (për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e “*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*”, shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
76. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rithekson se parashtuesi i kërkesës, përtej pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i caktimit të ekspertit “*në kundërshtim me dispozitat ligjore*” nga ana e Përmbartuesit Privat përmes Konkluzionit [P.nr.224/15] të 22 tetorit 2015, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i “*dispozitave ligjore*” nga gjykatat e rregullta, të cilat parashtuesi i kërkesës nuk i ka saktësuar në kërkesën e tij, mund të ketë qenë “*qartazi i gabuar*”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtuesin e kërkesës apo se si procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe të kenë qenë arbitrare.
77. Për më tepër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit ka marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit dhe pretendimet e parashtuesit të kërkesës të paraqitura përmes ankesës së debitorëve kundër Urdhrit [P.nr. 224/15] të 11 tetorit 2016 të Përmbartuesit Privat.
78. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton Aktvendimin [PPP. nr. 74/15] e 7 tetorit 2015 të Gjykatës Themelore, përmes të cilit Përmbartuesi Privat ishte urdhëruar që të caktojë ekspertin për vlerësimin e paluajtshmërisë. Përmbartuesi Privat në pajtim me Aktvendimin e lartcekur, përmes Konkluzionit [P.nr.224/15] të 22 tetorit 2015, e kishte caktuar ekspertin për vlerësimin e paluajtshmërive përkatëse. Bazuar në shkresat e lëndës, pas caktimit të ekspertit dhe vlerësimit të tij, Përmbartuesi Privat, përmes Konkluzioneve përkatëse, caktoi shitjen e parë dhe të dytë të paluajtshmërive përmes ankandeve publike. Kundër Konkluzioneve të lartcekura të Përmbartuesit Privat për shitjen e

paluajtshmërive, debitorët kishin parashtruar edhe një kërkesë për eliminimin e parregullsive në procedurën përmbarimore, përmes të cilës, ndër të tjera ishte kontestuar edhe çështja e caktimit të ekspertit.

79. Gjykata rikujton që Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP. nr. 85/2016] të 12 janarit 2017, refuzoi kërkesën e debitorëve për eliminimin e parregullsive në procedurën përmbarimore si të pathemeltë. Këtë konstatim të Gjykatës Themelore e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.845/2017] të 17 gushtit 2018 me të cilin kishte refuzuar ankesën e debitorëve, duke vlerësuar se: *“[...] aktvendimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore në të cilat kjo Gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare, e as në ato të cilat thirret ankesa. Njëherit pranë gjendjes faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejt është aplikuar e drejta materiale”*.
80. Tutje, Gjykata po ashtu vëren se çështja e caktimit të ekspertit nga Përmbaruesi Privat ishte ngritur edhe në ankesën e debitorëve kundër Urdhrit [P. nr. 224/15] të 11 tetorit 2017 të Përmbaruesit Privat. Në lidhje me ankesën e debitorëve, Gjykata rikujton Aktvendimin [Ac. nr. 4737/2017] e 3 gushtit 2018 të Gjykatës së Apelit, me të cilin kishte vërtetuar Urdhrin e lartcekur të Përmbaruesit Privat duke konstatuar se pretendimet e debitorëve në ankesën e tyre janë të pabazuara.
81. Prandaj, dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij përkitazi me përcaktimin e ekspertit *“në kundërshtim me dispozitat ligjore”* nga Përmbaruesi Privat, dhe rrjedhimisht, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të neneve 3, 33, 46 dhe 54 të Kushtetutës dhe instrumenteve ndërkombëtare

82. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të neneve 3, 33, 46 e 54 të Kushtetutës, për të cilat nuk ofron para Gjykatës asnjë arsytim, dhe po ashtu pretendon shkelje të instrumenteve ndërkombëtare, Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, respektivisht, duke mos saktësuar se cilat nene të këtyre dy instrumenteve ndërkombëtare, janë cenuar në rastin e tij.
83. Në adresimin e këtyre pretendimeve, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, përkatësisht kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar në mënyrë që të shpallet e pranueshme.
84. Gjykata rikujton që ky rregull, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, i mundëson Gjykatës që të shpallë të papranueshme pretendime të caktuara si *“qartazi të pabazuara”* në baza kushtetuese, nëse të

njëjtat, janë “*të pambështetura apo paarsyetuara*”. Gjykata konsideron se përkitazi me këtë kategori pretendimesh, ky është rasti.

85. Gjykata, në këtë kontekst thekson se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
86. Gjykata gjithashtu rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsytim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIO2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).
87. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e neneve 3, 33, 46 e 54 të Kushtetutës, pa argumentuar dhe arsyetuar shkeljen e të njëjtave përmes Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, si dhe pretendon shkelje të instrumenteve ndërkombëtare, Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, respektivisht, duke mos saktësuar se cilat nene të këtyre dy instrumenteve ndërkombëtare janë shkelur.
88. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 3, 33, 46 e 54 të Kushtetutës, si dhe shkelje të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, janë pretendime “*të pambështetura apo paarsyetuara*”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
89. Prandaj, dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse, (i) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, e që ndërlidhen me nulitetin e Kontratës së Kredisë dhe Hipotekës si rezultat i mungesës së “*legalizimit apo noterizimit të tyre*” dhe mungesës së “*pëlqimit për hipotekimin*” nga bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës, janë të papranueshme si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit, dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës; (ii) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës e që ndërlidhen me caktimin e ekspertit për vlerësimin e vlerës së paluajtshmërisë nga Përmbaruesi Privat, janë të papranueshme sepse janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit 47 e 48 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39

të Rregullores së punës; dhe (iii) pretendimet për shkelje të neneve 3, 33, 46 e 54 të Kushtetutës, si dhe shkelje të instrumenteve ndërkombëtare, Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, respektivisht, janë të papranueshme sepse të njëjtat janë pretendime “*të pambështetura apo paarsyetuara*”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese, siç është përcaktuar përmes neneve 47 dhe 48 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (d) dhe (2) dhe 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 24 qershor 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani
Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi